



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë më 17 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1446/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI52/19

Parashtrues

Drilon Sadriu

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme REV. nr. 6/2019, të 7 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Drilon Sadriu nga Vitia (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Visar Musa, avokat nga Vitia.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme REV. nr.6/2019, të 7 shkurtit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AC. nr. 2101/14 të 16 tetorit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, C. nr. 179/11, të 15 prillit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 10 (Liria e shprehjes) si dhe nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 mars 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu(kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 17 maj 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 25 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 maj 2010, në Viti kishte ndodhur një aksident trafiku, ku drejtuesi i automjetit të udhëtarëve të tipit „Opel Korsa“ goditi parashtruesin e kërkesës, duke i shkaktuar lëndime trupore.
10. Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykatës Komunale në Gjilan-Dega në Viti (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), më 28 mars 2011, sipas kallëzimit penal, nxori Aktgjykimin P. nr. 285/2010, me të cilin e shpalli drejtuesin e

automjetit të udhëtarëve të tipit „Opel Korsa“ fajtor për shkaktimin e aksidentit të trafikut, ndërsa parashtruesit të kërkesës ia caktoi shumëmonetare në lartësi prej 800 €, por këtë shumë parashtruesi i kërkesës e refuzoi si të ulët dhe joreal.

11. Parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë në Gjykatën Themelore kundër Kompanisë së Sigurimeve „Sigurimi“ për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial, si dhe për dhimbjet e përjetuara.
12. Më 15 prill 2014, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C.nr. 179/2011, me të cilin e miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe e urdhëroi Kompaninë e Sigurimeve „Sigurimi“, *“...që t’ia paguajë në emër të dëmit material dhe jomaterial për aksidentin shumëmonetare në lartësi prej 4,298€,për dhimbjet fizike dëmin jomaterial prej gjithsej 3,800 €, me kamatë prej 3.5%, duke filluar nga data 11.05.2011, apo nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”*. Ndërsa, në pikën II të Aktgjykimit, gjykata e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë për pagesën e shumës në lartësi prej 6,452 €, në emër të ndihmës së personit të tretë dhe të ushqimit të përforcuar.
13. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Kompania e Sigurimeve “Sigurimi” paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 182.2 të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje ndaj ankesës, në të cilën i kontestoi, si të pabazuara, argumentet e Kompanisë së Sigurimeve „Sigurimi“, me propozim që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore të vërtetohet.
15. Më 16 tetor 2014, Gjykata e Apelit e aprovoi pjesërisht ankesën e Kompanisë së Sigurimeve “Sigurimi” dhe nxori Aktgjykimin C.nr.2101/2014, me të cilin, nën pikën I të dispozitivit e ndryshoi shumëmonetare e gjykuar, në atë mënyrë që parashtruesit të kërkesës për dëmin material për dhimbjet fizike i caktohet shuma prej 1,500 € dhe për frikën e përjetuar shuma prej 1,300 €. Në pikën II të dispozitivit në lidhje me kamatën, Gjykata e Apelit e obligoi të paditurën që të paguajë shumëmonetare e gjykuar në lartësi të kamatës e cila paguhet nga bankat për mjetet e deponuara mbi një vit.
16. Në arsyetimin e Aktgjykimit AC.nr.2101/2014, në lidhje me pikën II të dispozitivit, Gjykata e Apelit konkludoi:

“Gjykata e Apelit, pas ekzaminimit të aktgjykimit të shkallës së parë, brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e pranoi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë, me konstatimin se ajo në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike në çështjen e paditësit të mitur, duke përfunduar drejtë se të njëjtit i takon e drejta e kompensimit të dëmit jo material dhe material, të cilin e ka pësuar si pasojë e aksidentit aktual, por që shumatat e gjykuara për dëmin jomaterial – dhimbje dhe frikë, janë tepër të larta dhe nuk përkojnë me natyrën e lëndimit të paditësit e as me

kriteret e aplikueshme nga kompanitë e sigurimeve që afarojnë në Kosovë e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, gjë që në këtë pjesë aktgjykimin e goditur e bënë të përfshirë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale... .”

17. Në arsyetimin e Aktgjykimit AC.nr.2101/2014, në lidhje me pikën II të dispozitivit, Gjykata e Apelit konkludoi:

“Aktgjykimi i goditur, edhe në pjesën që i referohet kërkesës aksesore të paditësit e cila ka të bëjë me kamatën e pranuar mbi shumat e gjykuara në shkallën prej 3.5 %, nga dita e ushtrimit të padisë, përkatësisht nga data 11.5.2011, e deri në pagesën definitive, është i gabuar si për nga koha ashtu edhe për nga lartësia, prandaj për të njëjtën arsye (zbatimi i gabuar i të drejtës materiale), edhe në këtë pjesë ndryshohet, ashtu që paditësit, mbi shumat e gjykuara i pranohet kamatë vonesë ligjore nga data 15.4.2014, që është dita e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë, kur të njëjtës i është dhënë mundësi që dëmin e paditësit ta shpreh në para, e deri në pagesën definitive, sipas normës së kamatës të cilën e paguajnë bankat që afarojnë në Kosovë, për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, gjë që është në pajtim me nenin 277 të LMD-së.”

18. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.
19. Më 7 shkurt 2019, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin REV. nr. 6/2019, me të cilin e hodhi poshtë, si të palejuar, revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 2010/2014, duke theksuar:

“Gjykata konkludoi se revizioni është i palejuar, nga se sipas dispozitës së nenit 211.2 të LPK, është e përcaktuar se revizioni nuk është i lejuar në kontestet pasurore-juridike, në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me kryerjen e ndonjë veprimi, nëse vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk kalon shumë prej 3000 €. Vlera e kontestit në pjesën e goditur është 700 €, e cila nuk kalon limitin e caktuar me ligj.”

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës përpiqet që pretendimet e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së t'i ndërtojë vetëm mbi një pohim, i cili është:

“Gjykata e Apelit në mënyrë absurde e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Themelore për bazën e dhembjeve fizike dhe kamatëvonesën pa kurrfarë baze ligjore, ashtu që në kundërshtim me ligjin përkatës – që ka të bëjë me autopërgjegjësinë si ligj special në dëm të paditësit. Po ashtu, Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon revizionin e paditësit kundër dy aktgjykimeve duke vërtetuar dy aktgjykime në kundërshtim me ligjin përkatës së auto përgjegjësisë dhe provat, në radhë të parë Gjykata është dashur në gjykoj në bazë të provave dhe Ligjit që është obligim i Gjykatës

të zbatoj këtë Ligj e jo kriteret e BQK-së që nuk janë ligj por rregullore e brendshme për kompanitë e sigurimeve, e jo në mënyrë arbitrare të veproj në mënyrë jokushtetuese dhe në kundërshtim me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut duke filluar nga neni 1 e deri te dispozita e fundit ku garantohen të drejtat e njeriut para gjykatave, si dhe në kundërshtim me vet Kushtetutën e Republikës së Kosovës.”

21. Më tej, në lidhje me shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës përpiqet ta ndërtojë shkeljen e pretenduar vetëm në pohimin se gjykatat gjatë procedurës së rregullt e kanë sjellë atë në një pozitë të pabarabartë, ndërsa përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 10 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës as nuk arsyetoi, dhe as nuk shpjegoi, cila është lidhja midis shkeljeve të pretenduara dhe natyrës së procedurës që ai kishte ndjekur në lidhje me kompensimin financiar.
22. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të aprovojë kërkesën e tij, të anulojë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe ta kthejë lëndën në rigjykim, *ose që gjykatat, si Gjykata e Apelit, ashtu edhe Gjykata Supreme, të marrin aktgjykime meritore në bazë të provave, fakteve dhe ligjeve, për çka konsideron se janë cenuar rëndë.*

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa Individuale]

“1, Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik”.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

26. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës REV. nr.6/2019, të 7 shkurtit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kriteret nga neni 48 i Ligjit dhe e dorëzoi kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

27. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

28. Gjykata nga kërkesa e parashtruesit vëren se ai konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, si dhe aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, duke pretenduar se ato i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe me nenin 10 (Liria e shprehjes) të KEDNJ-së.

29. Lidhur me këtë, Gjykata para së gjithash, vëren se procedura në fjalë ka të bëjë me përcaktimin e të drejtave civile të parashtruesit të kërkesës, më konkretisht, të së drejtës për kompensimin monetar në lidhje me kërkesëpadinë të cilën e kishte iniciuar para Gjykatës Komunale lidhur me aksidentin e trafikut. Prandaj, në rastin konkret kemi të bëjmë me një çështje të natyrës civile-juridike dhe nga kjo rezulton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së janë të zbatueshëm.

30. Megjithatë, duke shqyrtuar pretendimet e parashtruesit, Gjykata vëren se ai përpiqet që pretendimet për shkelje të drejtave kushtetuese dhe të drejtave të garantuara me KEDNJ t'i ndërtojë vetëm me një paragraf, në të cilin kryesisht thekson zbatimin e gabuar të ligjit dhe vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat, gjatë përcaktimit të lartësisë së kompensimit monetar, është dashur t'i bazojnë vendimet e tyre në ligj dhe jo „mbi kriteret e Bankës Qendrore të Kosovës, që nuk janë ligj”.

31. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës konsideron se ai për shkak të zbatimit arbitrar të së drejtës materiale është sjellë në një status të pabarabartë në procedurën para gjykatave të rregullta.
32. Rrjedhimisht, Gjykata, para së gjithash, tregon se sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese, detyra e këtyre gjykatave nuk është rishikimi i konkluzioneve të gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e së drejtës (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, të 30 qershorit 2005, kërkesa nr. 65167/01).
33. Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente për të zëvendësuar gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por në përgjithësi, është detyrë e gjykatave të rregullta që të vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i administruan (Shih, GJEDNJ, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 10 majit 2005, kërkesa numër 19354/02). Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë nëse, eventualisht, janë shkelur ose neglizhuar të drejtat kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar ose diskriminues.
34. Prandaj, Gjykata do të lëshohet përjashtimisht në shqyrtimin e mënyrës në të cilën gjykatat kompetente i kanë vërtetuar faktet dhe zbatuar rregulloret pozitive juridike mbi faktet e vërtetuara në këtë mënyrë, atëherë kur është evidente se në një procedurë të caktuar ka ekzistuar mënyra arbitrare e veprimit të gjykatës së rregullt, si në procedurën e vërtetimit të fakteve, ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregulloreve relevante pozitive juridike.
35. Gjykata Themelore vendimin për aprovimin e kërkesëpadisë e bazoi në dispozitën ligjore nëni 200, paragrafi 1, lidhur me nenin 185 të LMD-se (i vjetër), përkatësisht nëni 183, (LMD i ri). Ndërsa lidhur me kompensimin e dëmit jo material, gjykata vendimin e bazoi në nenin 323, paragrafi 1 i LPK-se.

Neni 183 Shpërblimi në të holla

“1. Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

2. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

36. Gjykata, në bazë të fakteve të rastit konkret dhe pretendimeve ankimore, gjen se Gjykata Themelore e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, si

dhe, duke marrë parasysh provat dhe ekspertizën, nxori aktgjykimin me të cilin ia ndau parashtruesit të kërkesës një shumë të caktuar monetare, si një formë të kompensimit për lëndimet fizike dhe dhimbjet shpirtërore.

37. Rrjedhimisht, Gjykata, në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore nuk gjen asgjë që do të çonte në përfundimin se ka ekzistuar veprimi arbitrar i gjykatës, si në procedurën e vërtetimit të fakteve, ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregulloreve relevante pozitive juridike.
38. Më tej, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se „Gjykata e Apelit e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore pa kurrfarë baze ligjore”, Gjykata i gjen këto pretendime të pabazuara dhe atë për arsye se Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj gjeti se Gjykata Themelore kishte vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, por që shumat e gjykuara për dëmin jomaterial – dhimbje dhe frikë, janë tepër të larta dhe nuk përkojnë me natyrën e lëndimeve të paditësit e as me kriteret e aplikueshme, gjë që në këtë pjesë aktgjykimin e goditur e bënë të përfshirë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.
39. Në bazë të asaj që u tha, rezulton se Gjykata e Apelit konkludoi se Gjykata Themelore i kishte vërtetuar drejtë faktet, por kishte nxjerrë konkluzione të gabuara, gjë që çoi edhe në zbatimin e gabuar e të drejtës materiale dhe rrjedhimisht ajo nxori një aktgjykim të ndryshëm.
40. Gjykata konstaton se një qëndrim i tillë i Gjykatës së Apelit është në pajtim me nenin 211 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshmë: LPK), i cili thotë:

“Neni 211. Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes kryesore drejtpërsëdrejti, me aktgjykim e ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë, po që se konstaton se ekziston ndonjëri nga këto shkaqe të treguara në ankesë:

[...]

d) nëse konsideron se gjendja faktike e përmbajtur në aktgjykimin e shkallës së parë është konstatuar drejtë, por e drejta materiale është zbatuar gabimisht nga gjykata e shkallës së parë.”

41. Më tej, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se “Gjykata Supreme e refuzon revizionin kundër dy aktgjykimeve që janë në kundërshtim me ligjin përkatës të auto përgjegjësisë dhe provat”, Gjykata gjen se Gjykata Supreme në procedurën sipas revizionit nuk i trajtoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me ligjshmërinë e aktgjykimeve të kontestuara, siç pretendon parashtruesi në kërkesë, por vetëm me çështjen procedurale e parashikuar në dispozitën e nenit 211 të LPK-së. Më konkretisht, Gjykata Supreme konkludoi se revizioni nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 211.2 të LPK-së.

“Neni 211.2 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit, ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro.”

42. Në bazë të të gjitha të lartcekurave, Gjykata konkludon se në rastin konkret nuk ka gjetur asgjë që do të tregonte se rregulloret materiale-juridike janë zbatuar arbitrarisht apo padrejtësisht në dëm të parashtruesit të kërkesës. Gjithashtu, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ofron fakte që do justifikojnë pretendimin se ekziston shkelja e të drejtave kushtetuese në të cilat thirret, prandaj, nuk ekzistojnë elementet të cilat *prima facie* tregojnë se shkelja e të drejtave kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së është e mundur dhe se do të ishte i nevojshëm një shqyrtim meritor.

Pretendimet e tjera

43. Gjykata më tej gjen se parashtruesi në kërkesën e tij pretendon edhe shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 10 (Liria e shprehjes) të KEDNJ-së. Megjithatë, Gjykata gjithashtu gjen se ai këto pretendime nuk i arsyetoi me asnjë fjalë, në mënyrë që kjo Gjykatë të mund të lëshohet në shqyrtimin e tyre, por as procedura gjyqësore e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në lidhje me kompensimin monetar në asnjë mënyrë nuk ngre çështje që lidhen me të drejtat e mbrojtura me këtë nen. Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara.
44. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi se gjykatat e rregullta gjatë procedurës gjyqësore e kishin sjellë atë në një pozitë të pabarabartë, duke shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.
45. Gjykata gjithashtu rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për mosdiskriminim sipas nenit 14 të KEDNJ-së është një e drejtë shtesë. Kjo do të thotë se ky nen nuk siguron një të drejtë të pavarur dhe autonome për mosdiskriminim, por në diskriminim sipas këtij neni mund të thirret vetëm në lidhje me "*gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga KEDNJ*". Ndonëse konstatimi i shkeljes së të drejtave të garantuara nuk është një parakusht për zbatimin e nenit 14 të KEDNJ-së, megjithatë, ky nen nuk do të mund të zbatohet nëse faktet e rastit në fjalë nuk bien "në kuadër" të të drejtave të garantuara (shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë*, i 18 korrikut 1994, Seria A numër 291-B, paragrafi 22).
46. Në rastin konkret, Gjykata tashmë ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për ç'arsye pretendimet e tij nuk bien brenda fushëveprimit të këtyre neneve, ashtu që nuk mund të zbatohet neni 14 i KEDNJ-së.
47. Gjykata, në bazë të të gjitha të lartcekurave, thekson se është obligim i parashtruesit t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë ndonjë provë *prima facie* që tregon për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).

48. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 shtator 2019, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi